



**I.** Dosja që do të dorëzojë kandidati, duhet të përmbajë, dokumentat si më poshtë:

1. CV e kandidatit;
2. Fotokopje e ID;
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike dhe Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike në FTI, UPT ose të diplomave ekuivalente me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
4. Listë e noterizuar e notave e studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave, ose i studimeve të ekuivalentuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
5. Nota mesatare e ponderuar (për të dy ciklet e studimit së bashku  $\geq 7.5$ , është kusht detyrues hyrës);
6. Për kandidatët të cilët kanë të paktën gradën “Doktor” apo tituj akademik nuk kërkohet nota mesatare;
7. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT, ose Universiteti/Fakulteti ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Prof. Asoc;
8. Leje me shkrim nga titullari i institucionit/kompanisë ku është i punësuar, që lejon angazhimin e kandidatit në mësimdhënie si pedagog i ftuar në FTI, UPT për vitin akademik 2017-2018.

**II.** Skeda pikëzuese e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve do të përmbajë këto fusha kryesore:

1. Diploma Bachelor/Master i Shkencave, në FTI/UPT ose në Fakultete Inxhinierike jashtë shtetit (me ekuivalencat përkatëse në MAS) ose në Fakultete Inxhinierike që i përkasin Universiteteve Shtetërorë brenda vendit, sipas formimit të kërkuar specifik. 0 - 10 pikë;
2. Nota mesatare e ponderuar për Ciklet Bachelor dhe Master i Shkencave të marra së bashku. Nota më e ulët mesatare e pranuar do të jetë e njëjtë me pragun e vendosur nga Senati Akademik për rekrutimet e stafit të brendshëm akademik. 0 - 20 pikë;
3. Çertifikata e mbrojtjes së gjuhës Angleze dhe pikët/vlerësimi përkatës. 0 - 10 pikë;
4. Kualifikime apo trajnime të tjera, të lidhura me formimin akademik apo fushat ku kandidati kërkohet të mbulojë, të provuara më çertifikata apo diploma përkatëse, të njohura/ekuivalentuara sipas legjislacionit Shqiptar. 0 - 10 pikë;
5. Eksperiencia e mëparshme në mësimdhënie në FTI/UPT apo në Universitete shtetërore brenda vendit, apo në Universitete jashtë vendit. Kjo duhet të provohet me vërtetime zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse dhe të njohura/ekuivalentura sipas legjislacionit Shqiptar. 0 - 10 pikë;



6. Artikuj të pranuar në konferenca apo simpoziumeve kombëtare/ndërkombëtare (që janë vlerësuar dhe rishikuar nga bordi editorial i konferencës/simpoziumit) dhe janë botuar në proceedings (me ISBN). 0 - 10 pikë;
7. Artikuj të pranuar për botim/botuar në revista shkencore kombëtare/ndërkombëtare (me ISBN) me bord editorial, të cilat janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak. 0 - 10 pikë;
8. Artikuj të pranuar për botim/botuar në revista shkencore kombëtare/ndërkombëtare (me ISBN) me bord editorial dhe me faktor impakti. 0 - 10 pikë;
9. Grada shkencore Doktor. 30 pikë;
10. Tituj Akademike Prof. Asoc, ose Prof. 30 pikë.

Maksimumi i pikëve sipas këtij vlerësimi është 150 pikë.

**III.** Gjeni ju lutem me poshtë, nevojat e Departamentit të Inxhinierisë Informatike për presonel akademik të ftuar, në të Ciklin e Parë, për lëndët që mbulohen nga DII në FTI:

❖ **Bachelor në Inxhinieri Informatike**

**2(dy) personel akademik i ftuar**

Nr	Semestri II-rë Bachelor në Inxhinieri Informatike / Emërtimi i lëndës	Kreditet përkatëse
1	Algoritmet e programimit të avancuar	0.5K laborator
2	Teknikat dhe gjuhët e programimit	0.5K laborator